

## **AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “Euroasia Travel & Tours” shpk,**

Në Tiranë, sot më datë 30.08.2021, une i poshtëshënuari: Abdul Motin lindur ne Noakhali,Bangladesh me date 01 Janar 1984,identifikuar me pasaporte numer EA0174239 , me cilësinë e “ortakut themelues”deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Euroasia Travel & Tours” shpk.**

### **Neni 1 Emri, Forma**

Shoqëria do të ketë emrin**“Euroasia Travel & Tours” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

### **Neni 2 Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

### **Neni 3 Selia**

Shoqëria **“Euroasia Travel & Tours” shpk** e ka seline në adresë: “Ruga Kostandin Kristoforidhi Ndertese Nr 9,Shkalla 1 Ap 12,Tirane” dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

### **Neni 4 Objekti i veprimtarisë**

Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërine **“Euroasia Travel & Tours” shpk** është: Agjensi udhetimesh,Ndertim faqesh internet, programe kompjuterike, aplikacione, krijim nderfaqe per perdoruesit etj.

### **Neni 5 Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

*Abdul Motin* *Abdul Motin*

## **Neni 6 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cila zotërohet si më poshtë: Abdul Motin lindur ne Noakhali,Bangladesh me date 01 Janar 1984,identifikuar me pasaporte me numer EA0174239,zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

## **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

*Abdul Motin*

*Abdul Motin*

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruarë në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrëthanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

**Neni 9**  
**Administrimi**

Administrator i shoqërisë **"Euroasia Travel & Tours" shpk** është: Abdul Motin lindur ne Noakhali, Bangladesh me date 01 Janar 1984, identifikuar me pasaporte numer EA0174239. Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqërisë që eshte data 30.08.2021.

**Neni 10**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik në Republiken e Shqipërisë.

**Neni 11**  
**Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare **"Euroasia Travel & Tours" shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES**

**Abdul Motin**



Tiranë, më datë 30.08.2021

## **STATUTI I SHOQËRISË “Euroasia Travel & Tours ”shpk.**

### **Neni 1**

#### **Emri, Forma**

Shoqeria do të ketë emrin **“Euroasia Travel & Tours” shpk** dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur me poshtë e “Shoqëria”.

### **Neni 2**

#### **Selia**

Shoqeria e ka selinë në adresë: “Ruga Kostandin Kristoforidhi,Ndertese Nr 9,Shkalla 1 Ap 12,Tirane”dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

### **Neni 3**

#### **Objekti i veprimitarise**

Objekti i ushtrimit të veprimitarise per shoqërinë **“Euroasia Travel & Tours”** është: Agjensi udhetimesh,Ndertim faqesh internet, programe kompjuterike,aplikacione, krijim nderfaqe per perdoruesit etj.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(një) kuote, i cili zotërohet si më poshtë: Abdul Motin lindur ne Noakhali,Bangladesh me date 01 Janar 1984,identifikuar me pasaporte me numer EA0174239 ,zoteron 100 % të kapitalit të shoqërisë.Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

### **Neni 6**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e

*Abdul Motin* *Abdul Motin*

registrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".  
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### Neni 7

#### Organji Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "Euroasia Travel & Tours" shpk është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat epermendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistroara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundershtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### Neni 8

#### Mënyra e thirrjes

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 9

#### Kuorumi

Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 10 të Statutit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike,

*Abdul Matin*

*Abdul Matin*

sipas parashikimeve të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”  
Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në pikën 1 të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

#### Neni 10

##### Marrja e vendimeve

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendlod me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në paragrin e parë të nenit 9 të këtij statuti, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.  
Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 7 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendlod me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

#### Neni 11

##### Administrimi

Administrator i shoqërisë “Euroasia Travel & Tours” është: Abdul Motin lindur ne Noakhali, Bangladesh me date 01 Janar 1984, identifikuar me pasaporte numer EA0174239. Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 30.08.2021.  
Asambleja e ortakëve emëron dhe shkarkon Administratorin e shoqërisë me shumicë të zakonshme. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët i ushtrojnë kompetencat bashkë ose veç e veç.

#### Neni 12

##### Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpala asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpala asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare te shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Abdul Motin

Abdul Motin

**Neni 13  
Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylet me 31 Dhjetor.

**Neni 14  
Bilanci i shoqërisë dhe dividentët**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblessë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

**Neni 15**

Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtarë për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne rastin e pikës b) Asambleja e Ortakëve merr vendim në të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër.

**Neni 16**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvèçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

**Neni 17  
Riorganizimi (bashkimi, ndarja, shndërrimi)**

Riorganizimi i shoqërisë (bashkim, ndarje, shndërrim) do të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

**Neni 18  
Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne statut, do te zbatohet ligji "Per tregtaret dhe

*Abdullah Matlin*

*Abdullah Matlin*

shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 19**

**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet që mund te lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 20**

**Dispozita përfundimtare**

Statuti i shoqerise "Euroasia Travel & Tours" shpk u redaktua në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lirë nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES**

**Abdul Motin**



Tiranë, më datë 30.08.2021